

STATUT DHE AKT THEMELIMI
PER KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TE SHOQERISE

“NDERTIME VELLEZRIT CAUSHI”

(Shoqeri me Përgjegjesi të Kufizuar)

Ne baze të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe, ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit"

Sot, më 07.01.2025, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “NDERTIME VELLEZRIT CAUSHI” shpk.

Themeluesit e shoqërisë janë:

- a) Edmond Caushi, atësia Kadri, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës numër personal identifikimi H70120194L i datëlindjes 20.01.1977, lindur në Rashnapoj; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- b) Maksim Caushi, atësia Kadri, shtetas shqiptar, identifikuar me anë pasaportës me numër personal identifikimi I00308223P i datëlindjes 08.03.1980, lindur në Rashnapoj; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

FORMIMI I SHOQERISE

Neni 1

Formohet shoqëria e quajtur **“NDERTIME VELLEZRIT CAUSHI”**

(Që këtu e më poshtë referuar si "Shoqëria", e cila themelohet nga **ortaket e sipërcituar**, si më poshtë vijon:

QENDRA E SHOQERISE

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Aleksandër Goga”, pasuria nr. 232/41, ZK 1031, Kati i parë, me sipërfaqe 16 m²,

Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin gjatë aktivitetit të saj, brenda ose jashtë territorit të vendit.

Edmond Caushi 

Maksim Caushi 

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte per nje periudhe kohore **te papercaktuar**.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete si me poshte vijon:

Ne fushen e projektimit dhe te ndertimit: planvendosje e objekteve te vecanta, projekte dhe ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. Deri ne dy kate dhe kompletimin me instalimet e nevojshme per to, b- projekte dhe ndertime civile industriale, turistike, bujqesore etj. Dhe kompletimin e instalimeve te nevojshme per to; d- Projektim peizazhi (sistemime, lulishte, vepra arti, dekor etj.) e projektim interieri, mobile, pajisjes, dizajn industrial. Ne fushen e ndertimit per zbatim: punime dhu, sistemime, tarracime, prodhim elementesh te parafabrikuara betoni e betonarmeje dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. Dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, punime elektrike, linja, impiante elektrike, telefoni, citofoni, dhe mirembajtja e tyre, ndertim rruge, ndertim fusha aviacioni, veshje asfaltobeton te rrugeve (ndertim mbishtrese) si dhe sistemim e asfaltim sheshe, ndertim vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndertime ujesjellesa dhe kanalizime, sillosa, kulla, kulla uji. Pre betonarmeje dhe metalike, punime karpentjerie metalike, shpime pusesh gjeologjike inxhinjerike dhe hidrogjeologjike, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, nivelime topografike, punime topogjeodezike, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash. Nivelime topografike, punime topogjeodezike, punime siperfaqe te gjelberia parqe, lulishte, instalimi i impianteve ngritese dhe transportuese (ashensore etj.) instalimi i impianteve te ngrohjes dhe ftohjes, instalimi i impianteve higjenike, instalimi i impianteve nenpresion, restaurimi i ndertesave monument kulture, punime restaurimi i ndertesave monument kulture, punime restaurimi ne vepra arkeologjike, ndertime gazsjellese, naftesjellese, ndertime diga, galeri, tunele, punime mbrojtje te sistemimit hidraulikcimentime, kanale dhe impiante vaditje, punime karpentiere druri dhe metali, instalimet dhe impianteve nenpresion, instalimet per nenstacionet, kabinat e transformatoreve. Prodhim, import — export beton, beton armeje dhe cdo nenproduktit te tij, interte etj. Organizimi i transportit te udhetareve dhe te mallrave me mjete te komunikacionit ajror, tokesor dhe detar, celja e zyrave te agjencive turistike dhe te shitjes se biletave per udhetime brenda dhe jashte vendit me te gjitha llojet e

Edmond Causi

Mohsin Pruli

mjeteve, organizimin e shërbimeve, ndihme juridike, kurse profesionale për gjuhë të huaja, kompjuter dhe sekretari, shitje kancelari. Në fushën e tregtisë import - eksporti, me shumicë dhe pakicë, të mallrave industriale, ushqimore, bujqësor dhe blegtorale, veshmbathje, konfeksione, prodhime e tregtim të materialeve të ndërtimit, inerte, rërë, zhavorr, automjeteve, makinerive, pajisjeve hidro-sanitare, mobileve, artikujve kozmetike, lendeve të përpunuara dhe të papërpunuara, e bimeve medicinale, të lendeve drusore, plastike, duraluminit, tregtim me pakicë të karburanteve dhe vajrave lubrifikante. Në fusha të tjera: hapjen e bar bufeve, restoranteve, pikave të servilit, parkim automjetesh, lavazhit, hoteleve, fshatrave turistik, moteleve si dhe agjencive për shitblerje, dhenie me qira të pasurive të tundshme dhe të patundshme, agjencive për shitblerje, agjenci komisioneve, agjenci transporti, transport të udhëtareve dhe të mallrave si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij. Për të realizuar objektin e aktivitetit të saj, Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë, dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm, të lidhur, instrumental, të përafërt, elementar, ose sidoqoftë të dobishëm, për shembull: Të ofrojë garanci reale dhe/ose personale si për detyrime të vetat, ashtu edhe për të tretet. Të marrë përsipër, të lejojë dhe të heqë dorë nga pjesëmarrje direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe ndërmarrje, si Shqiptare ashtu edhe të huaja, që kryejnë veprimtari të tyre të tilla, me qëllim që të lehtësojnë realizimin e objektit social; Veprimtari tregtare dhe industriale, import dhe eksport të mirash, mallrash, shërbimesh dhe produkteve. Në kuadër të ligjit, të krijojë veprimtari dhe degë e filiale të përfaqesimit. Shërbime punëtorie Brenda dhe jashtë Shqipërisë..

Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të Ortakëve të Vetëm dhe sipas parashikimeve të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali fillestar i shoqërisë është 500.000 lekë, i ndarë në 2 kuota.

- 1) Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a) Ortaku themelues Maksim Caushi, zotëruar 1 (një) kuota me vlerë të përgjithshme 250.000 Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b) Ortaku themelues Edmond Caushi, zotëruar 1 (një) kuota me vlerë të përgjithshme 250.000 Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortakët mund të vendosin të rrisin kapitalin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore në

Edmond Caushi

Maksim Caushi

fuqi dhe me vendim te ortakeve te vetem. Detyrimet e ortakeve kundrejt shoqerise do te mbulohen vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tyre. Ortaket nuk do te kete asnje pergjegjesi tjeter per detyrime te tjera te shoqerise.

Neni 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te zvogelohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

REGJISTRIMI I SHOQERISE

Neni 8

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te bizneseve (QKB) sipas nenit 43 te ligjit 9723 date 3.5.2007.

Neni 9

KALIMI I KUOTAVE

Pjeset shoqerore te ortakut te vetem perputhen me pjesen e tij ne kapitalin e shoqerise.

Kuotat e kapitalit te shoqerise si dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) shitblerjes se kuotave
- c) trashegimise
- d) dhurimit
- e) çdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Pjeset e tij çdo ortak i shoqerise mund t'ua ofroje te treteve, te cilet nuk jane anetare ne shoqeri. Ne rast se shoqeria do te kete ne te ardhmen me shume se nje ortak, ne kete rast ortaku i cili ka vendosur te transferoje ose te shese kuotat e tij, duhet t'i drejtoje nje kerkese me shkrim Organit Administrativ duke saktesuar çmimin e shitjes, i cili duhet te jete i arsyeshem dhe te jete i njejte me ate qe do t'i ofrohet dhe nje personi te trete jashte shoqerise si dhe te dhenat e bleresit

E drejta e perparemise per nenshkrimin e kapitalit eshte ne proporcion me kuotat e secilit prej ortakeve.

Edmond Lushi

Maksim Lushi

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes nga çasti i kalimit te kuotave deri ne çastin e regjistrimit te kalimit.

Shoqeria regjistron kalimin e kuotave sipas nenit 43 te ligjit 9723.

Neni 10

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit , duhet te jete te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te tretave. Shoqeria do te kete vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

Neni 11

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper *vete* te drejtat dhe detyrimet kontraktore

Organet e shoqerise jane:

- 1- Asambleja e Ortakeve te Shoqerise
- 2- Administratori i shoqerise.

KOMPETENCAT E ORTAKEVE

Neni 12

Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, Ortaket shprehen me vendime per gjithçka qe eshte ne kompetencat e tyre.

Neni 13

Marrja e vendimeve te Ortakeve regjistrohen ne regjistrin e vendimeve te ortakeve ,mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentet e tjera qe kane te bejne mete duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

Neni 14

THIRRJA E ASAMBLESE

Asambleja e pergjithshme thirret sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

Edmond Causi

Robeim Paul

Neni 15

PJESEMARRJA NE VENDIME

Çdo ortak, ne rastet kur shoqeria do te kete me shume se nje ortak, ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja duhet te vendose per çeshtje qe kerkojne shumice te kualifikuar si per shembull ndryshime ne statut, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te regjistruar, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe shperndarja e shoqerise ajo mund te marre vendime te vlefshme kur vendos me tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarrës personalisht, ose qe votojne me shkrese po me mjete elektronike.

ADMINISTRIMI

Neni 16

Shoqeria administrohet nga dy administrator te cilet caktohen ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Vendimet e Asamblese se Ortakeve . Administratoret qendrojne ne detyre per nje periudhe **kohore 5 (pese) vjeçare**, me te drejte rimerimi nepermjet vendimit te Ortakeve te Shoqerise. Ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e secilit administrator , Ortaket vendosin shkarkimin e tij. Ne asnje rast ortaket nuk i duhet te justifikojne apo provojne se cilat jane shkaqet per te cilat shkarkojne administratoret. Ne çdo rast jane ortaket te cilet vleresojne nese ka shkaqe te arsyeshme per shkarkimin e administratoreve.

Administratoret detyrohet te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme.

Ata kujdesen per mbajtjen sakte dhe te rregullt te dokumenteve, dhe te librave kontabel te shoqerise.

Edmond Cushi

Modhaim Pushi

Ata nenshkruajn bilancin vjetor te shoqerise, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e filimeve ja paraqet keto dokumente asamblese se pergjithshem te ortakeve per miratim.

Ata kane te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise ja jep shprehimisht Ortakeve t e s h o q e r i s e .

Administratoret emerohen me nje afat kohor 5(pese) vjeçar.

Administratoreve nuk i lejohet te kontraktoje me te tretet ne çfaredo lloj forme qofte, nuk i lejohet te marri hua tek shoqeria, te japi pelqimin per çeshtje te ndryshme ne emer te saj, nuk u lejohet te jape paradhenie, te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te shoqerise apo te ortakeve etj., perveç rasteve kur ai ka marre nje **miratim perkates me shkrim nga ortaket.**

Administratoret kane te drejte te kryeje vetem ato veprime te cilat kane te bejne me administrimin e perditshem dhe te zakonshem te shoqerise.

Administratoret mund te japin prokura tek te tretet brenda kufijve qe ligji e lejon dhe ne kufijte qe i lejojne Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh.

Te gjitha veprimet e tjera duke perfshire pagesa, detyrime per tu paguar, veprime me institucionet bankare ku perfshihen transferta bankare terheqje parash etj., do te kryhen nga administratoret vetem pasi te jete dhene miratimi me shkrim nga ortaket e shoqerise.

Administratoret e shoqerise jane caktuar

Z.Maksim Caushi, i datelindjes 08.03.1980, lindur ne Rashnapoj, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporten me nr ID. I00308223P.

Dhe

Z.Edmond Caushi, i datelindjes 20.01.1977, lindur ne Rashnapoj madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruari identifikuar me pasaporte me nr ID . H70120194L.

Edmond Caushi

Maksim Caushi

Neni 16.1

**ADMINISTRATORET KANE TE DREJTE TE VEPROJNE TE PAVARUR
NGA NJERI TJETRI DUKE E PERFAQESUAR SHOQERINE SI NE
ORGANET SHTETERORE ASHTU DHE NE BANKA TE NIVELIT TE
DYTE.**

MARREDHENIET E PUNES

Neni 17

Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 18

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Neni 19

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te emerohet dhe qendroje ne detyre sipas parashikimeve te ligjit perkates. Ortaku cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Edmond Gashi

Mohsin Gashi

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 20

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit. Administratori merr masat me qellim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e tjera do ti kalojne ortakut te shoqerise.

Neni 21

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rast se shoqeria shperndahet per do lloj arsye Ortaku i vetem percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c 'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit te biznesit QKB.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 22

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", dhe ligjit nr.9723. date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Çdo ndryshim behet ne perputhje me kete Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Data.07.01.2024

ORTAKET E SHOQERISE

Ndertime Vellezerit Caushi

Edmond Caushi



Maksim Caushi



